

# DITARI MUJOR

SHKURT 2025



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

## PREZANTOHET RAPORTI I OECD/SIGMA, PIRDENI: DËSHMI E RRUGËTIMIT PROGRESIV TË SHqipËRISË DUKE E POZICIONUAR LIDER RAJONAL NË DISA SEKTORË

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në bashkëpunim me OECD/SIGMA, organizoi eventin "Transformimi i Sektorit Publik: Themeloret e Reformës së Administratës Publike në Shqipëri". Gjatë eventit, u prezantuan gjetjet e raportit të monitorimit OECD/SIGMA, ku Shqipëria shquhet si lider rajonal në shumicën e indikatorëve të matur, duke konfirmuar progresin e saj në administratën publike. Në event morën pjesë Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama, Drejtuesi i Programit SIGMA të OECD-së, Z. Gregor Virant, si dhe përfaqësues të lartë të qeverisë dhe partnerë ndërkombëtarë. Ministrja Pirdeni, theksoi se të dhënat e SIGMA-s në shtyllat e vlerësimit konfirmojnë qartë progresin e prekshëm të Shqipërisë në reformën e administratës publike. Analiza e raportit monitorues të SIGMA-s është një dëshmi e rrugëtimit progresiv të Shqipërisë në reformën e administratës publike duke e pozicionuar lider rajonal në disa sektorë dhe fusha kyçe, përfshirë këtu, manaxhimin e financave publike, qeverisjen digjitale, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe zhvillimin e politikave.



## MADRID, MINISTRJA PIRDENI, PJESË E DELEGACIONIT SHQIPTAR, PRITET NGA MBRETI I SPANJËS, FELIPE VI

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, ishte pjesë e delegacionit të drejtuar nga Kryeministri Edi Rama në Madrid të Spanjës, gjatë një vizite dy-ditore (6 dhe 7 shkurt 2025).

Në Pallatin Mbretëror Zarzuela, delegacioni shqiptar u prit nga Madhëria e Tij, Mbreti Felipe VI. Ky takim u zhvillua në kuadër të pjesëmarrjes në ceremoninë e Çmimit Universal Spanjoll (Espanol Universal Award), një çmim prestigjioz ndërkombëtar që i jepet personave me kontribut të shquar në promovimin e kulturës, gjuhës dhe trashëgimisë spanjolle në mbarë botën. Gjatë kësaj vizite, u nënshkrua një marrëveshje me rëndësi të veçantë për organizimin në Tiranë të Kongresit Botëror të Ligjit 2027.

## MINISTRJA PIRDENI BASHKËBISEDON ME STUDENTËT E KOLEGJIT TË EVROPËS NË KAMPUSIN E TIRANËS

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Znj. Adea Pirdeni, zhvilloi një leksion të hapur me 32 studentët e Kolegjit të Evropës në kampusin e Tiranës, të ardhur nga 22 vende të ndryshme.

Takimi u fokusua në rrugëtimin e Shqipërisë për një shtet të së drejtës sipas standardeve të familjes evropiane ku Shqipëria aspirojnë të jetë shumë shpejt pjesë. Leksioni i hapur u organizua në kuadër të lëndës "Konsolidimi Demokratik dhe Sundimi i Ligjit në Evropën Juglindore". Gjatë bashkëbisedimit me studentët, ministrja Pirdeni theksoi se Reforma në Drejtësi ka shënuar një pikë kthese të rëndësishme teksa ndau me studentët tre fazat kyçe të zhvillimit të sundimit të ligjit në vendin tonë. Studentët e Kolegjit të Evropës, të cilët vijnë nga kontekste të ndryshme akademike dhe profesionale, u angazhuan aktivisht në diskutim, duke drejtuar pyetje dhe perspektiva mbi sfidat e sundimit të ligjit në vendin tonë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.





# DITARI MUJOR

SHKURT 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTËR SHTETI PËR  
ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE ANTIKORRUPSIONIN

## MINISTRJA PIRDENI: PEZULLOHEN PROCEDURAT E REKRUTIMIT PËR DY KATEGORI PUNONJËSISH PËRGJATË PERIUdhËS PARA ZGJEDHORE!

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni duke iu referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025" deklaroi se DAP do të pezullojë procedurat e rekrutimit nga data 11 prill deri në 11 maj 2025 për procedurat e rekrutimit të punonjësve në shërbimin civil. "Parashikohet shprehimisht në këtë vendim, që sikurse diktohet nga Kodi Zgjedhor, DAP do të pezullojë të gjitha procedurat e rekrutimit për periudhën e fushatës zgjedhore, pra nga 11 prilli deri në 11 maj, me qëllim që të garantohet një proces zgjedhor i rregullt dhe i drejtë," tha Pirdeni. Ministrja Pirdeni shtoi se duke filluar nga data 3 mars 2025 do të ndalohet çdo procedurë rekrutimi përmes institucioneve që rekrutojnë punonjësit e tyre përmes Kodit të Punës. "Por në këtë vendim ne kemi kaluar në një nivel tjetër për të garantuar një standard edhe më të lartë të garantimit të paanshmërisë të procesit zgjedhor duke parashikuar që prej datës 3 mars 2025 do të ndalohet çdo procedure rekrutimi nga institucionet që rekrutojnë punonjësit e tyre përmes Kodit të Punës. Natyrisht procedurat e nisura do të duhet të përfundojnë, por asnjë procedurë e re punësimi në ministri në institucionet e varësisë, por edhe në ato shoqëri aksionere me kapital shtetëror nuk mund të zhvillohen. Në raste të konsideruara si të jashtëzakonshme, kur cenohet dhënia e shërbimit për qytetarët në institucionet e infrastrukturës kritike, shëndetësisë, arsimit dhe institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, nën përgjegjësinë e drejtuesit të institucionit, mund të zhvillohen përjashtimisht procedura rekrutimi," u shpreh Pirdeni.



## THIRRJA PËR EKSELENTËT SJELL 105 TË RINJ TË TALENTUAR NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE, MINISTRJA PIRDENI: DO JENI NËN MENTORIMIN E PROFESIONISTËVE!

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, zhvilloi një takim mirëseardhjeje me të rinjtë ekselentë të përzgjedhur nga "Thirrja për Ekselentët", një program i cili synon angazhimin e të rinjve më të talentuar në administratën shtetërore.

Gjatë kësaj thirrjeje, e gjashta në radhë, 105 ekselentë u përfshinë në administratë nga një total prej 463 aplikimesh. Ata janë shpërndarë në 50 institucione publike, me 80 prej tyre në Tiranë dhe 25 në rrethe, duke reflektuar një angazhim të gjerë institucional për mbështetjen e kësaj nisme.

Në fjalën e saj, ministrja Pirdeni vlerësoi përkushtimin akademik të të rinjve dhe nënvizoi se ky program është pjesë e një vizioni më të madh për përgatitjen e brezit të ri të administratës shqiptare në kuadër të integritetit evropian. Të rinjtë e punësuar falë kësaj thirrjeje do të përfitojnë përvojë pune 1-vjeçare dhe pas një viti mund të aplikojnë në pozicionet e tyre apo dhe pozicione të tjera duke përmbushur kriterin e eksperiencës që kërkohet në fazën e rekrutimit me konkurs. Fillimisht të rinjtë do të trajnohen nga trajnerët e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).



Ministër i Shtetit për Administratën  
Publike dhe Antikorrupsionin  
Adea Pirdeni



mapa.gov.al  
adeapirdeni



APirdeni